

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Levrent Bushi nga Prizreni, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të Lartë Publik nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73.73.195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 24.09.012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Levrent Ali Bushi, i lindur më 19.08.1981 në Prizren, ku edhe tani jeton në Rr. "Fetah Gega" nr. 13 në Prizren, i pa martuar, Këshilltar politik në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, fakultetin e kryer, i gjendjes së mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Është përgjegjës

Sepse me si Zyrtar i lartë Publik, në Këshilltar politik në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike**, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

DENIMI

Me gjobë në shumë prej **1000 (njëmijë)** Euro. Gjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Paga bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po që se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njehta do të zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njëjtë sikurse gjobën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr. 01 1813 të dt. 21.05.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të shënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se si Këshilltar Politik në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë për shkak të angazhimeve të shumta nuk ka mundur të deklaroj pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin i deklaratës se të pandehurit, ushtruesit të Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe bazë të dhënave të parashtuara në kërkesë, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është dënuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kurse mbrojtjen e të pandehurit e hudhi si të pa bazë.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK andaj të LMK-ës të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit të i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA
Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksa.

Duke marrë parasysh se...	
Emri	DPK/DMP
Numri	03-3560/12
Data	05-10-2012
01	